



Br/Nr. 889 /25
Tuzi - Tuz, 15.12. 2025. godine

Pijace sh.p.k Tuzi
Tregu d.o.o Tuzi

Na osnovu člana 26 stav 1 Zakona o komunalnim djelatnostima („Službeni list Crne Gore“ , broj 55/16, 74/16, 02/18, 140/22,85/25) i člana 28 stav 1 alineja 7 Statuta Društva sa ograničenom odgovornošću „Pijace/Tregu“ Tuzi , **Odbor direktora Društva** na Predlog izvršnog direktora na III. Sjednici , održanoj dana 15.12.2025. godine, donio je

ODLUKU

1. **USVAJA SE** Program obavljanja komunalnih djelatnosti Društva sa ograničenom odgovornošću „Pijace/Tregu“ Tuzi za 2026. godinu, u formi predloga.
2. Tekst Programa iz stava 1 ove Odluke, čini sastavni dio Odluke.
3. Na Programu obavljanja komunalnih djelatnosti Društva sa ograničenom odgovornošću „Pijace/Tregu“ Tuzi za 2026. godinu, saglasnost daje Osnivač
4. Odluka stupa na snagu danom donošenja.

Obrazloženje

Članom 26 stav 1 Zakona o komunalnim djelatnostima („Službeni list Crne Gore“ , broj 55/16, 74/16, 02/18, 140/22, 85/25) propisano je da se komunalne djelatnosti obavljaju u skladu sa godišnjim programom obavljanja istih, koje na predlog vršilaca komunalnih djelatnosti donosi skupština jedinici lokalne samouprave do kraja tekuće, za narednu godinu. Program iz stava 1 ovog člana naročito sadrže: vrstu, obim i dinamiku obavljanja poslova komunalne infrastrukture, opreme i sredstva, finansijska sredstva potrebna za realizaciju programa i načina obezbjeđivanja sredstva.

Dok članom 28, stav 1 alineja 7 Statuta Društva propisano između ostalog da Odbor direktora donosi godišnji plan, uz saglasnost Osnivača.

Broj : 889 /25
U Tuzima, 15.12.2025. godine

ODBOR DIREKTORA DRUŠTVA

PREDSJEDNIK

Luvigj Junčaj



"PIJACE/TREGU" d.o.o.

Broj. 889/25-1

Tuzi, 15.12 2025 god.



Pijace sh.p.k Tuz
d.o.o Tuzi **Tregu**

SHPK "PIJACE / TREGU" TUZ

**PROGRAMI
I KRYERJES SË VEPRIMTARISË KOMUNALE
PËR VITIN 2026.**

Tuz, dhjetor 2025

PËRMBAJTJA

I	Hyrje
II	Të dhënat themelore mbi ushtruesin e veprimtarisë komunale ▪ Të dhënat themelore identifikuese ▪ Forma e organizimit ▪ Aktet themeluese ▪ Çështjet juridike - statusore ▪ Struktura e pronësore ▪ Organizimi i brendshëm dhe skema organizative ▪ Veprimtaritë themelore dhe dytësore të ushtruesit të veprimtarisë komunale ▪ Organet udhëheqjes dhe drejtimi
III	Kapacitetet e ushtruesit të veprimtarive komunale ▪ Resurset njerzore ▪ Hapësirat afariste dhe objektet e infrastrukturës komunale ▪ Pajisjet dhe parku i makinave
IV	Qëllimet e ushtruesit të veprimtarive komunale ▪ Përmirësimi i krejt veprimtarisë ▪ Realizimi i bashkëpunimit me organët, shërbimet publike dhe organizatat e tjera që kanë ndikim në zbatimin e këtij Programi
V	Bazat për përpilimin e Programit
VI	Planifikimi i aktivitetit fizik
VII	Treguesit e planifikuar financiarë ▪ Të ardhurat e planifikuara ▪ Shpenzimet e planifikuara ▪ Struktura e të ardhurave dhe shpenzimeve
VIII	Politika e rrogave dhe punësimit
IX	Borxhi
X	Plani i prokurimit publik
XI	Politika e çmimeve
XII	Vërejtjet përfundimtare

I HYRJË

Sjellja e Programit vjetor për kryerjen e veprimtarive komunale parashikohet me dispozitat e nenit 26 paragrafi dhe nenit 29 paragrafi 2 pika 7 të Ligjit mbi veprimtaritë komunale ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 55/16, 74/16, 02/18, 66/19, 140/22,85/25) si dhe me Regulloren mbi përmbajtjen e detajuar të programit vjetor mbi kryerjen e veprimtarive komunale dhe raportit vjetor për zbatimin e programit vjetor mbi kryerjen e veprimtarive komunale ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 54/20).

Po ashtu, Udhëzimi mbi hartimin e Programit Vjetor dhe raportit mbi punën dhe realizimin e funksionit të vetëqeverisjes lokale, i cili është sjell nga Kryetari i Komunës së Tuzit (Akti nr. 01-041/24-663 /1 prej më 1 shkurt 2024), përcakton ndër të tjera përmbajtjen, mënyrën, procedurën dhe afatet e përgatitjes së programit vjetor të punës dhe të raportit për punën e shërbimeve publike.

Veprimtaria komunale e mirëmbajtjes së tregjeve si dhe krejt veprimaria e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "Pijace/Tregu" Tuz në vitin 2026 do të kryhet në përputhje me rregulloret e mëposhtme:

Ligjet themelore

- Ligji mbi shoqëritë afariste ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 65/20, 146/21, 04/24,91/25, 121/25);
- Ligji mbi veprimtaritë komunale ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 55/16, 74/16, 02/18, 66/19, 140/22, 85/25);
- Ligji mbi punë ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 74/19, 08/21, 59/21, 68/21, 145/21, 77/24, 84/24, 86/24, 122/25);
- Ligji mbi vetëqeverisjen lokale ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 02/18, 34/19, 38/20, 50/22, 84/22, 81/25, 98/25);
- Ligji mbi prokurimin publik ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 74/19, 03/23, 11/23, 84/24);
- Ligji mbi qasje të lirë në informacione ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 44/12, 30/17, 66/25);
- Ligji mbi mbrojtjen dhe shëndetin në punë ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 34/14, 44/18, 84/24);
- Ligji mbi pagat e punonjësve të sektorit publik ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 16/16, 83/16, 21/17, 42/17, 12/18, 39/18, 42/18, 34/19, 130/21, 146/21, 92/22, 152/22, 152/22, 113/23, 48/24,84/24);
- Ligji mbi mbrojtjen e konsumatorit ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 02/14, 06/14, 43/15, 70/17, 67/19, 146/21, 84/24);
- Ligji mbi marrëdhëniet e detyrimeve ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 47/08, 04/11, 22/17, 123/24);
- Ligji mbi pronën shtetërore ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 21/09, 40/11, 23/25);

- Ligji për fiskalizimin në qarkullimin e produkteve dhe shërbimeve ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 46/19, 73/19, 08/21);
- Ligji për tregtinë e brendshme ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 49/08, 40/11, 38/19, 84/24).

Rregulloret e vetëqeverisjes lokale të Tuzit

- Vendimi mbi rëndin komunal të Komunës së Tuzit ("Fleta zyrtare e MZ - dispozitat komunale", nr. 33/19);
- Vendimi mbi tregje ("Fleta zyrtare e MZ - dispozitat komunale", nr. 33/19, 62/22);
- Vendimi mbi themelimin e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Pijace/Tregu" Tuz ("Fleta zyrtare e MZ - dispozitat komunale", nr. 40/21);
- Statuti i SHPK "Pijace/Tregu" Tuz mbi të cilin Kuvendi Komunal i Tuzit dha pelqimin nr. 02-030/21-15710 prej më 23.12.2021 ("Fleta zyrtare e MZ - dispozitat komunale", nr. 46/21);
- Kontrata mbi besimin e kryerjes së veprimtarive komunale dhe shfrytëzimin e infrastrukturës komunale si dhe mjeteve të tjera në pronësi të Komunës së Tuzi, (numri i regjistrimit i Komunës së Tuzit, 01-041/23-199 prej më 13.01.2023 dhe numri i regjistrimit i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "Pijace/Tregu" Tuz, 22/23 prej më 13.01.2023), si dhe Aneksi i parë i Kontratës në fjalë (numri i regjistrimit i Komunës së Tuzit, 01-015/24-345/1 prej më 22.01.2024 dhe numri i regjistrimit i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "Pijace/Tregu" Tuz, 320/24 prej më 22.01.2024).

Me këtë Program, Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Pijace/Tregu" Tuz planifikon të sigurojë vazhdimësi në ofrimin e shërbimeve për konsum individual komunal, për të vazhduar me mirëmbajtjen e hapësirave të shitjes të vendosura në objektet e tregut që Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Pijace/Tregu" Tuz menaxhon dhe me të cilin gjeneron të ardhura (tregu i mallrave të përzier dhe tregu i Gjelibër).

Me këtë Program, Shoqërisa me Përgjegjësi të Kufizuar "Pijace/Tregu" Tuz, do të planifikojë që me mirëmbajtjen e vazhdueshme dhe cilësore të objekteve të saj të kujdeset për të siguruar interesin publik dhe stabilitetin afarist.

II TË DHËNAT THEMELORE MBI USHTRUESIN E VEPRIMTARISË KOMUNALE

Në këtë pjesë të Programit, do japim të dhëna dhe informacione themelore lidhur me SHPK "Pijace/Tregu" Tuz si ushtrues i veprimtarisë komunale të mirëmbajtjes së objekteve të tregut.

II/1 Të dhënat themelore identifikuese

Ushtruesi i veprimtarisë komunale është Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Pijace/Tregu" Tuz me seli në Tuz, në adresën Tuz p.n. Numri i indenifikimit tatimor i Shoqëris (NIPT) është 03399109.

Themeluesi i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "Pijace/Tregu" Tuz është Kuvendi i Komunës së Tuzit, NIPT: 02628988 me seli në Tuz.

II/2 Forma e organizimit

Kuvendi i Komunës së Tuzit ka sjell Vendimin mbi themelimin e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar „Pijace/Tregu“ Tuz me seli në Tuz, në adresën Tuz p.n. ("Fleta zyrtare e MZ - dispozitat komunale", nr. 40/21 prej më 03.12.2021) si shoqëri njëanëtarëshe me përgjegjësi të kufizuar.

II/3 Aktet themeluese

Aktet themeluse të Shoqërisë janë Vendimi mbi themelimin e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar „Pijace/Tregu“ Tuz me seli në Tuz, në adresën Tuz p.n. numër 02-030/21-14528 prej më 24.11.2021 (Fleta zyrtare e MZ - dispozitat komunale", nr. 40/21 prej më 03.12.2021), Statuti i SHPK "Pijace/Tregu" Tuz numër 08-032/21 -14776 prej më 01.12.2021, mbi të cilin Kuvendi i Komunës së Tuzit dha pelqimin me Vendim nr. 02-030/21-15710 prej më 23.12.2021 ("Fleta zyrtare e MZ - dispozitat komunale", nr. 46/21) si dhe Kontrata mbi besimin e kryerjes së veprimtarive komunale dhe shfrytëzimin e infrastrukturës komunale si dhe mjeteve të tjera në pronësi të Komunës së Tuzit (numri i regjistrimit i Komunës së Tuzit, 01-041/23-199 prej më 13.01.2023 dhe numri i regjistrimit i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "Pijace/Tregu" Tuz, 22/23 prej më 13.01.2023). Duhet cekur se Kontrata në fjalë është ndryshuar me anë të Aneksit (numri i regjistrimit i Komunës së Tuzit, 01-015/24-345/1 prej më 22.01.2024 dhe numri i regjistrimit i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "Pijace/Tregu" Tuz, 320/24 prej më 22.01.2024).

II/4 Çështjet juridike - statusore

Statusi juridik i Shoqërisë rregullohet me aktin themelues, d.m.th. me *Vendim mbi themelimin e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar „Pijace/Tregu“ Tuz* numër 02-030/21-14528 prej më 24.11.2021 (Fleta zyrtare e MZ - dispozitat komunale", nr. 40/21 prej më 03.12.2021), *Statut të SHPK "Pijace/Tregu" Tuz* numër 08-032/21 -14776 prej më 01.12.2021 si dhe me *Kontratë mbi besimin e kryerjes së veprimtarive komunale dhe shfrytëzimin e infrastrukturës komunale si dhe mjeteve të tjera në pronësi të Komunës së Tuzit*, (numri i regjistrimit i Komunës së Tuzit, 01-041/23-199 prej më 13.01.2023 dhe numri i regjistrimit i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "Pijace/Tregu" Tuz, 22/23 prej më 13.01.2023). Duhet cekur se Kontrata në fjalë është ndryshuar me anë të *Aneksit* (numri i regjistrimit i Komunës së Tuzit,

01-015/24-345/1 prej më 22.01.2024 dhe numri i regjistrimit i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "Pijace/Tregu" Tuz, 320/24 prej më 22.01.2024).

II/5 Struktura pronësore

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Pijace/Tregu" Tuz është themelua nga ana e Kuvendit të Komunës së Tuzit me Vendim mbi themelimin e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar „Pijace/Tregu“ Tuz (Fleta zyrtare e MZ - dispozitat komunale”, nr. 40/21 prej më 03.12.2021) si shoqëri njëanëtarëshe dhe si e tillë është në pronësi të Komunës së Tuzit.

II/6 Ogranizimi i brendshëm

Në pajtim me Rregulloren aktuale mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës (nr. 576/24-1 prej më 15.03.2024.) format bazë të organizimit të Shoqërisë janë sektoret, dhe ato janë:

- *Spektori për çështje teknike - operative dhe*
- *Spektori për çështje ekonomiko - juridike.*
- Në kuadër të Sektorit për çështje tekniko - operative funksionon Shërbimi i çështjeve të tregut i cili ka në përbërjen e tij dy (2) reparte - *reparti i tregut të gjelbër* si dhe *reparti i mallrave të përzier*.
- Ndërsa në kuadër të Sektorit për çështje ekonomiko - juridike funksionojnë dy shërbime *shërbimi i financave dhe shërbimi për çështje juridike dhe të përgjithshme*.

II/7 Veprimtaritë themelore dhe dytësore të ushtruesit së veprimtarive komunale

Veprimtaritë kryesore dhe dytësore që Shoqëria kryen dhe për të cilat është e regjistruar në Regjistrin Qendror të Subjekteve Afariste, janë përcaktuar me **Vendimin mbi themelimin, Statutin e Shoqërisë**, si dhe me **Kontratën për besimin e kryerjes së veprimtarive komunale** (numri i regjistrimit i Komunës së Tuzit, 01-041/23-199 prej më 13.01.2023 dhe numri i regjistrimit i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "Pijace/Tregu" Tuz, 22/23 prej më 13.01.2023). Kontrata në fjalë është ndryshuar me anë të **Aneksit** (numri i regjistrimit i Komunës së Tuzit, 01-015/24-345/1 prej më 22.01.2024 dhe numri i regjistrimit i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "Pijace/Tregu" Tuz, 320/24 prej më 22.01.2024).

Veprimtaritë kryesore dhe dytësore që Shoqëria kryen dhe për të cilat është e regjistruar në Regjistrin Qendror të Subjekteve Afariste janë të përcaktuara në Statutin e Shoqërisë.

Statuti i Shoqërisë përcakton veprimtarinë bazë që kryen Shoqëria, e cila është me interes publik dhe është e regjistruar në Regjistrin Qendror të Subjekteve Afariste me kodin 8299:

- ndërton, mirëmban dhe menaxhon objektet e tregut;
- ruan higjienën e përgjithshme në zonën e tregut dhe objektet tjera në pronësi të komunës së Tuzit;

- kryen punë të tjera në interesin publik.

Krahas këtyre aktiviteteve, Shoqëria kryen edhe veprimtari që nuk kanë karakter të aktiviteteve me interes publik, përkatësisht:

- përgatit dhe zbaton programe në fushën e investimeve;
- investimi në ndërtimin e objekteve me investim të përbashkët me investitorë të tjerë;
- marrja me qira e pasurive të paluajtshme dhe menaxhimi i pasurive të paluajtshme.

II/8 Organet e udhëheqjes dhe drejtimit

Shoqërinë e udhëheq Themeluesi në mënyrë dhe në kushte të përcaktuara me Vendimin mbi themelimin e Shoqërisë në bazë të Statutit të Shoqërisë, me ç'gjë sigurohet interesi publik.

Kuvendi i Komunës së Tuzit, si Themelues:

- miraton aktin e themelimit, ndryshimet dhe plotësimet e aktit të themelimit të Shoqërisë;
- jep pëlqimin për Statutin e Shoqërisë;
- shqyrton raportin mbi punën dhe sjell Vendimin mbi shpërndarjen e profitit;
- emëron dhe shkarkon anëtarët e Bordi të drejtorëve;
- sjell vendimin mbi ndryshimin e formës, ristrukturimin dhe likuidimin vullnetar të Shoqërisë;
- jep pëlqimin për ndryshimin e emërimit, veprimtarisë, selisë dhe kapitalit themelor të Shoqërisë;
- jep pëlqimin për çmimorën e shërbimeve, të cilën e përcakton Bordi i drejtorëve;
- kryen veprime të tjera në pajtim me ligjin, Vendimin mbi themelimin dhe Statutin.

Organe e Shoqërisë janë Bordi i drejtorëve si organ i drejtimit dhe Drejtori ekzekutiv si organ i udhëheqjes i Shoqërisë.

Bordi i drejtorëve:

- drejton Shoqërinë dhe jep udhëzime drejtorit ekzekutiv në aspektin e udhëheqjes së punëve të Shoqërisë;
- sjell Statutin e Shoqërisë, me pajtim të themeluesit;
- emëron drejtorin ekzekutiv;
- i propozon themeluesit ndryshimin e kapitalit themelues;
- përcakton politikën afariste të Shoqërisë dhe sjell akte për zbatimin e saj në pajtim me udhëzimet e themeluesit;
- kryen mbikëqyrjen e udhëheqjes së Shoqërisë;
- sjell planin vjetor të punës dhe planin vjetor financiar, në pajtim me themeluesin;

- i propozon themeluesit miratimin e raportit vjetor mbi realizimin e planit vjetor të punës si dëshmisë financiare;
- përcakton çmimoren për kryerjen e shërbimeve të Shoqërisë, në pajtim me themeluesin;
- i propozon themeluesit shpërndarjen e fitimit dhe mënyrën e mbulimit të humbjeve;
- sjell aktin mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, në pajtim me Kryetarin e Komunës;
- përcakton politikat e kontabilitetit të Shoqërisë dhe politikës së menaxhimit të rizikut;
- jep dhe shkarkon prokurën;
- miraton raportet tremujore të drejtorit ekzekutiv mbi veprimtarinë e Shoqërisë;
- sjell Rregulloren e procedurave mbi punën e Bordit të drejtorëve;
- kryen detyra tjera në pajtim me ligjin dhe Statusin e Shoqërisë.

Bordi i drejtorëve përbëhet nga pesë (5) anëtarë, që janë përfaqësuesit e Themeluesit.

Drejtori ekzekutiv, si organ i udhëheqës së Shoqërisë kryen këto detyra si në vijim:

- përfaqëson dhe prezanton Shoqërinë;
- lidh kontrata në emër të Shoqërisë;
- organizon dhe udhëheq veprimtarinë e Shoqërisë;
- menaxhon pasurinë e Shoqërisë;
- zbaton vendimet e Shoqërisë;
- vendos mbi dispozicionin e mjeteve financiare të Shoqërisë;
- propozon programe dhe plane në fushat për të cilat është themeluar Shoqëria;
- përgatit propozon e planit vjetor të punës dhe planin financiar të Shoqërisë;
- përgatit raportin vjetor mbi realizimin e programit vjetor të punës së Shoqërisë si dhe dëshminë financiare;
- vendos mbi të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e të punësuarve në pajtim me ligjin;
- kryen dhe detyra të tjera lidhur me punën dhe veprimtarinë e Shoqërisë, në pajtim me ligjin, me Vendimin mbi themelimin dhe me Statutin e Shoqërisë.

Shoqëria është e obliguar që ta informojë vazhdimisht themeluesin dhe subjektet tjera që shprehin interes ligjor për përcjelljen e punës dhe funksionimin e saj.

III KAPACITETET E USHTRUESIT TË VEPRIMTARISË KOMUNALE

III/1 Resurset njerëzore

Aktualisht, në Shoqëri janë të angazhuar 38 punëtorë.

Nëse do të ketë rritje në vëllimin e punës gjatë vitit aktual, Shoqëria do të angazhojë një numër shtesë ekzekutuesish, në përputhje me rregulloret pozitive shtetërore dhe aktet e Shoqërisë.

III/2 Hapësirat afariste dhe objektet e infrastrukturës komunale

Me qëllim të zbatimit të veprimtarisë komunalate të Ushtruesit, veprimtarinë komunale, për të cilën është themeluar, do t'i kryejë në objektet që vijojnë:

Objektet	Adresa
1. Tregi i gjelbër	Tuz p.n.
2. Tregu i mallrave të përzier	Tuz p.n.

Tregu i mallrave të përziera ka në dispozicion 426 vende të shitjes, me një sipërfaqe totale prej 5278 m².

Tregu i gjelbër ka 22 tezga për shitjen e frutave dhe perimeve, 6 vende për shitjen e peshkut si dhe 6 vende shitjeje për lule. Në kuadër të tregut të gjelbër ekziston edhe lokali afarist, të cilin Shoqëria e jep në qira.

III/3 Pajisjet dhe parku i veturave

Shoqëria do të kryejë veprimtarinë e besuar me pajisjet ekzistuese, të cilat janë përcaktuar nga regjistri i mjeteve të luajtshme dhe të paluajtshme në pronësi të Shoqërisë.

IV QËLLIMET E SHOQËRISË

IV/1 Përmirësimi i krejt veprimtarisë

Qëllimet e Shoqërisë do të orientohen në mirëmbajtjen dhe përmirësimin e kushteve të objekteve të tregut. Me mirëmbajtje e objekteve dhe higjienës së tregut do të garantohet vend i sigurt dhe të parrezikshëm për kryerjen e punëve të besuara.

Në zonën e Tuzit ekziston edhe një numër i madh i ekonomive bujqësore, që tepricat e prodhimeve të veta i plasojnë në tregun e gjelbër, që është i njohur si vend ku mund të gjenden prodhimet vendore. Gjithashtu edhe tregu i mallrave të përzier është i njohur për numrin e madh të vizituesve dhe si vend i tregtisë së llojllojshme, për këtë arsye një numër i madh i qytetarëve nga komunat fqine vizitojnë objektet tona të tregut. Lidhur me këtë, Shoqëria do të ketë si qëllim

avancimin e kushteve të punës në tregje si dhe për punën e saj të njihet si ndërmarrje që do të kryejë me sukses veprimtarinë me interes publik.

Në programin e punës për vitin 2025 ishte planifikuar të hartohej projekti kryesor i rikonstruksionit të pazarit të mallrave të përziera. Ky projekt, së bashku me auditimin e tij, ndërkohë është përfunduar dhe i është dërguar Ministrisë së Punëve Publike për procedim të mëtejshëm. Bazuar në këtë, dhe duke pasur parasysh që rikonstruksioni është propozuar në buxhetin shtetëror për vitin 2026, pritet që gjatë vitit 2026 të fillojnë punimet për rikonstruksion, të cilat përfshijnë riparimin e çatisë dhe instalimin ri elektrik.

Me organizimet e planifikuara, në vitin 2026 Shoqëria do të angazhohet për mirëmbajtjen dhe zgjerimin e plotësimit të kapaciteteve të tregut.

Më në fund, qëllimi dhe detyra e Shoqërisë është të ruajë likuiditetin aktual dhe aftësinë paguese të saj, të rrisë nivelin e faturimit për shërbimet dhe të zgjidhë kërkesat nga përdoruesit e shërbimeve, të gjitha me qëllim të përmirësimit të veprimtarisë për të cilën Shoqëria është themeluar.

IV/2 Realizimi i bashkëpunimit me organët, shërbimet publike dhe organizatat e tjera që kanë ndikim në zbatimin e këtij Programi

Për realizimin efikas dhe me sukses të detyrave programore është e nevojshme të vazhdohet bashkëpunimi me Komunën e Tuzit si themelues i Shoqatës në aspektin e arritjes së qëllimeve programore të kësaj Shoqërie, si dhe me Kryetarin dhe Kuvendin të Komunës së Tuzit përmes dhënies së pëlqimit për vendimet e organeve drejtuese, si dhe me të gjitha organet e administratës lokale dhe organet e tjera kompetente, përkatësisht me:

- Sekretariatit për zhvillim dhe projekte (si organ mbikëqyrës i qeverisjes lokale që jep mendim dhe pëlqimin mbi akte të caktuara të Shoqërisë);
- Me të gjitha ndërmarrjet dhe shërbimet tjera publike, themelues i të cilave është Komuna e Tuzit;
- Si dhe si me institucionet e tjera publike relevante, në nivel lokal dhe atë qendror.

V BAZAT PËR PËRPILIMIN E PROGRAMIT

Hartimi i Programit për kryerjen e veprimtarive komunale për vitin 2026 bazohet në Rregulloren mbi përmbajtjen e detajuar të programit vjetor mbi kryerjen e veprimtarive komunale dhe raportit vjetor për zbatimin e programit vjetor mbi kryerjen e veprimtarive komunale ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 54/20) si dhe në bazë të të ardhurave dhe daljeve të planifikuara.

VI PLANIFIKIMI I AKTIVITETIT FIZIK

- Të ardhurat e planifikuara në tregun e mallrave të përzier në bazë të kontratës për përdorimin e shërbimeve

Vendet e shitjes	Numri i vendeve të shitjes	Të ardhurat e planifikuara në bazë të vendeve të shitjes për vitin 2025
Vendet primare të shitjes	255	445.966,00
Vendet sekondare të shitjes	40	72.500,00
Në total	295	518.466,00

- Të ardhurat e planifikuara në tregun e gjelbër në bazë të kontratës për përdorimin e shërbimeve

Vendet e shitjes	Numri i vendeve të shitjes	Të ardhurat e planifikuara në bazë të vendeve të shitjes për vitin 2026
Tezgat	22	8.750,00
Spektori i peshkut	6	90,00
Spektori për shitjen e luleve	6	660,00
Kiosku	1	6.000,00
Në total	35	15.500,00

- Të ardhurat e planifikuara në tregun e mallrave të përzier në bazë të pagesës ditore

Vendet e shitjes	Numri i vendeve të shitjes	Të ardhurat e planifikuara në bazë të vendeve të shitjes për vitin 2026
Vendet primare të shitjes	131	90.000,00 (pagesa mesatare ditore 226,00)
Në total	131	90.000,00

VII TREGUESIT E PLANIFIKUAR FINANCIARË

Në pjesën e mëposhtme vijon një paraqitje tabelare e planit financiar për vitin 2026 me shpjegime, dmth. me strukturë të tyre.

VII/1 Të ardhurat e planifikuara për vitin 2026

	TË ARDHURAT	
61	1. Të ardhurat nga shitja e produkteve dhe shërbimeve në tregun e brendshëm	
6122	Të ardhurat nga shërbimet për personat fizikë dhe juridikë në vend	623.966,00
	NË TOTAL 1	623.966,00
64	2. TË ARDHURAT NGA PREMITË, SUBVENCIONET, DOTACIONET, DONACIONET ETJ.	
6403	Të ardhurat nga donacionet (transferet nga buxheti i Komunës)	90.000,00
	NË TOTAL 2	90.000,00
65	3. TË ARDHURAT TË TJERA NGA VEPRIMTARIA	
659	Të ardhurat të tjera nga veprimtaria	20.000,00
	NË TOTAL 3	20.000,00
	TË ARDHURAT TOTALE	733.966,00

VII/2 Shpenzimet e planifikuara për vitin 2026

	Paraqitja analitike	PLANI 2026
	SHPENZIMET	
27	I TAKSA MBI VLERËN E SHITUAR	80.000,00
	Detyrimet mbi TVSH-në	80.000,00
46	DETYRIMET TË TJERA	35.000,00
469	Detyrimet të tjera	35.000,00

Shpenzimet materiale

51	II SHPENZIMET MATERIALE	41.000,00
5120	Shpenzimet e materialeve për mirëmbajtjen e higjienës	1.000,00
5121	Shpenzimet e materialeve të zyrës	2.000,00
5124	Shpenzimet e materialeve të tjerë	2.000,00
5130	Shpenzimet e energjisë elektrike	36.000,00

Shpenzimet e pagave, kompensimi i pagave dhe shpenzimet e tjera personale

52	III SHPENZIMET E PAGAVE, KOMPENSIMI I PAGAVE DHE SHPENZIMET E TJERA PERSONALE	473.962,00
5200	Kostot neto të pagave për punë të rregullt	372.000,00
5207	Shpenzimet e taksave mbi pagën dhe shtesat e pagave që përballohen nga punonjësi	17.620,00
5208	Shpenzimet e kontributeve të pagave dhe shtesave të pagave që përballohen nga punonjësi	46.281,00
5210	Shpenzimet e taksave mbi pagën dhe shtesat e pagave që përballohen nga punëdhënësi	4.334,00
5211	Shpenzimet e kontributeve të pagave dhe shtesat e pagave që përballohen nga punëdhënësi	5.627,00
522	Kostot e kompensimit sipas kontratës mbi vepër	10.000,00
526	Pagesa për anëtarët e Bordit të drejtorëve	9.600,00
529	Përfitime të tjera personale	8.500,00

Kostot e shërbimeve të prodhimit

53	IV KOSTOT E SHËRBIMEVE TË PRODHIMIT	68.700,00
5312	Shërbime të komunikimit	5.700,00
5334	Kostot e qirasë së objektit afaristë	36.000,00
534	Kostet e organizimit të panairit	2.500,00
539	Kostot e shërbimeve të tjera	24.500,00

Shpenzimet jomateriale

55	V SHPENZIMET JOMATERIALE	28.804,00
5501	Kostot për shërbimet e avokatit	2.904,00
5509	Kostot e shërbimeve të tjera joprodhuese	21.500,00
5510	Kostot e përfaqësimit dhe bifesë	3.000,00
5524	Kostot e sigurimit të punonjësve gjatë punës	600,00
5530	Shërbimet bankare / provizjonet	800,00

57	VI SHPENZIMET TË TJERA	6.500,00
57942	Shpenzimet për blerjen e pajisjeve dhe veshjeve për të punësuarit	500,00
57943	Shpenzimet për blerjen e kompjuterëve dhe printerëve	2.000,00
57946	Shpenzimet për blerjen e pajisjeve për zyra dhe objekte të tregut	2.500,00
	Shpenzimet për blerjen e mobiljeve të zyrës	1.500,00

PLANI FINANCIAR PËR VITIN 2026

VII PLANI FINANCIAR PËR VITIN 2026	2026
TË ARDHURAT TOTALE TË PLANIFIKUARA	733.966,00
SHPENZIMET TOTALE TË PLANIFIKUARA	733.966,00
FITIMI / HUMBJA	0,00

BURIMET FINANCIARE

Burimet financiare janë:	2026
BURIMI I TË ARDHURAVE	SHUMA
Të ardhurat e planifikuara nga burimet vetanake	623.966,00
Mjetet nga buxheti i Komunës	90.000,00
Të ardhurat të tjera nga veprimtaria	20.000,00
GJITHSEJIT:	733.966,00

VII/3 Struktura e të ardhurave dhe shpenzimeve

Sipas Programit të kryerjes së veprimtarive komunale për vitin 2026, pritet që Shoqëria të operojë me rezultat financiar zero pozitiv.

Me Programin e kryerjes së veprimtarive komunale për vitin 2026, Shoqëria planifikon të ardhurat me vlerë prej 733.966,00 €.

Të ardhurat janë planifikuar në bazë të të ardhurave të realizuara të Shoqërisë në vitin 2025 dhe rritjes së planifikuar në vitin 2026.

Në pozicionin numërin rendor 1, grupi i llogarisë 61 - të ardhurat nga shitja e produkteve dhe shërbimeve në tregun e brendshëm në vlerë prej 623.966,00 € përbëhen nga:

Ofrimi i shërbimeve në Tregun e mallrave të përzier/pagesat ditore;

- të ardhura të planifikuara prej 90.000,00 €

Të ardhurat në Tregun e mallrave të përzier në bazë të kontratës për përdorimin e shërbimeve;

- të ardhura të planifikuara 518.466,00 €

Të ardhura nga Tregu i gjelbër në bazë të kontratës për përdorimin e shërbimeve;

- të ardhura të planifikuara 15.500,00 €.

Në pozicionin me numër rendor 2, grupi i llogarisë 64, të ardhura nga primet, subvencionet, dotacionet, donacionet etj. në vlerë prej 90.000,00 €, përbëhen nga:

- të ardhura nga donacionet (transfera nga buxheti i Themeluesit, Komuna e Tuzit) 90.000,00€.

Në pozicionin me numër rendor 3, grupi i llogarisë 64, të ardhurat të tjera operative në vlerë prej 20.000,00 €, përbëhen nga:

- të ardhurat të tjera operative 20.000,00 €.

Me programin e kryerjes së veprimtarive komunale për vitin 2026, Shoqëria planifikon shpenzime totale në vlerë prej 733,966,00 €.

Llogaria e grupit 27, tatimi mbi vlerën e shtuar, është planifikuar në vlerë prej 80.000,00 €.

Llogaria e grupit 46, detyrime të tjera në shumen 35.000,00 € përbëhet nga:

- detyrime të tjera nga viti 2025 në shumen 35.000,00 €

Llogaria e grupit 51 në vlerë prej 41.000,00 € përbëhet nga:

- shpenzimet e materialeve për mirëmbajtjen e higjienës në vlerë prej 1.000,00 €
- shpenzimet e materialeve të zyrës në vlerë prej 2.000,00 €
- shpenzimet e materialeve të tjerë në vlerë prej 2.000,00 €
- shpenzimet e energjisë elektrike në vlerë prej 36.000,00 €.

Llogaria e grupit 52 përbëhet nga shpenzimet e pagave bruto prej 473.962,00 €.

Struktura e këtyre kostove është e detajuar në planin financiar. Shpenzimet nga ky grup janë planifikuar në bazë të numrit të punëtorëve që janë të nevojshëm për qëndrueshmërinë dhe procesin e punës së kësaj Shoqërie. Poashtu, këtu marrin pjesë edhe pagesat për anëtarët e Bordit të drejtorëve.

Llogaria e grupit 53, kostot e shërbimeve të prodhimit në vlerë prej 68.700,00 € përfshijnë:

- shpenzimet e shërbimeve të komunikimit në vlerë prej 5.700,00 €:

- (-mirëmbajtja e arkës fiskale 200,00 €),

- (-rrjeti i telefonisë celulare 3.500,00 €),

- (-shërbimet e internetit 2.000,00 €)

- shpenzimet për qirat të objekteve që shfrytëzon Shoqëria në vlerë prej 36.000,00 €:

- (-qira për objektin e Tregut të gjelbër 24.000,00 €),

- (-qira për zyrat e Shoqërisë 12.000,00 €)

- shërbime tjera në vlerë 24.500,00 €, prej së cilave:

- shpenzimet për shërbim të siguris në punë në vlerë 2.000,00

- shpenzimet për katalogun e rregulloreve në vlerë prej 1.000,00 €

- shpenzimet e shërbimeve të dezinfektimit, deratizimi dhe dezinfektiminë vlerë prej 3.500,00 €
- shpenzimet për sponsorizim në vlerë prej 10.000,00 €
- shpenzimet për organizimin e panairit 2.500,00 € dhe
- shpenzimet për shërbime të tjera 8.000,00 €.

Llogaria e grupit 55, shpenzimet jomateriale në vlerë prej 28.804,00 € përfshijnë:

- kostot për shërbime të avokatit 2.904,00 €
- kostot e shërbimeve të tjera joprodhuese në vlerë prej 21.500,00 € prej së cilave:
- shpenzimet e zhvillimit dhe mirëmbajtjes së softverit në vlerë prej 3.000,00 €
- shpenzimet e shërbimeve komunale në vlerë prej 18.500,00 €
- (-deponimi i mbeturinave komunale 16.885,00 €)
- (-shpenzimet për ujë nga rrjeti i ujësjellësit 1.615,00 €)

- shpenzimet e përfaqësimit dhe bifes në shumën 3.000,00 €
- (-kapsula kafeje 1.600,00 €)
- (-shpenzimet e përfaqësimit dhe bifes 1.400,00 €)
- shpenzimet e sigurimit të punonjësve gjatë punës në vlerë prej 600,00 €
- kosto për shërbime bankare / provizjone në vlerë 800,00 €.

Llogaria e grupit 57, shpenzimet të tjera në vlerë prej 6.500,00 € përfshijnë:

- shpenzimet për blerjen e pajisjeve dhe veshjeve për të punësuarit në vlerë prej 500,00 €
- shpenzimet për blerjen e kompjuterëve dhe printerëve në vlerë prej 2.000,00 €
- shpenzimet për blerjen e pajisjeve për zyra dhe objekte të tregut në vlerë prej 2.500,00 €
- shpenzimet për blerjen e mobiljeve të zyrës në vlerë prej 1.500,00 €.

Shpenzimet janë planifikohen sipas aktiviteteve programore të Shoqërisë dhe kostove të pritshme që janë të nevojshme për funksionimin normal të saj.

VIII POLITIKA E RROGAVE DHE PUNËSIMIT

Në këtë pjesë, është e rëndësishme të theksohet rritja e pagave për punonjësit e Shoqërisë për arsye të miratimit të ndryshimeve dhe plotësimeve të Kontratës kolektive të degës për shërbime komunale ("Fleta zyrtare e Malit të Zi", nr. 02/12, 32/12, 93/23), me të cilat ndër të tjera parashikohën koeficientë më të lartë për vendet e punës, të drejta më të larta dhe kushte të punës më të favorshme për punonjësit. Poashtu duhet cekur edhe rritjen shtesë e pagave neto sipas programit Europa tani 2, prej muajit tetor 2024.

Tabelat 1, 2 dhe 3 të cilat vijnë në tekstin e Programit, përcaktohen si përmbajtje e detyrueshme të Programit, në përputhje me pikën 10 të shtesës 1 të Rregullores (politika e pagave dhe punësimit) mbi përmbajtjen e detajuar të programit vjetor mbi kryerjen e veprimtarive komunale.

Tabela 1. Struktura e punonjësve sipas formimit profesional, d.m.th. nivelit e kualifikimit të arsimit

LLOJI I PUNËS	VI, VII nivel ose më shumë	IV nivel	III nivel	I1 ose I2 nivel	PK
PUNËT E MENAXHIMIT - DREJTIMIT	4				
PUNËT ADMINISTRATIVE - TEKNIKE		2			
PUNËT FINANCIARE - TË KONTABILITETIT	1				
PUNËT JURIDIKE	1				
VEPRIMTARIA THEMELORE		11	1	1	
MIRËMBAJTJA				5	2
PUNËT LOGJISTIKE		1	3	6	
GJITHSEJIT - 38	6	14	4	12	2

Tabela 2. Struktura e punonjësve sipas moshes

Programi i kryerjes së veprimtarive komunale për vitin 2026

LLOJI I PUNËS	18-25	26-35	36-45	46-55	56-65	Mbi 65
PUNËT E MENAXHIMIT - DREJTIMIT		3			1	
PUNËT ADMINISTRATIVE - TEKNIKE		1	1			
PUNËT FINANCIARE - TË KONTABILITETIT				1		
PUNËT JURIDIKE			1			
VEPRIMTARIA THEMELORE	1	7	2	1	2	
MIRËMBAJTJA		1	2	4	1	
PUNËT LOGJISTIKE	1		2	5	1	
GJITHSEJIT – 38	2	12	8	11	5	0

Tabela 3. Struktura e punonjësve sipas viteve të shërbimit

LLOJI I PUNËS	Deri në 5 vite	6 - 10	11 - 15	16 – 25	26 - 35	Mbi 35
PUNËT E MENAXHIMIT – DREJTIMIT	2	1		1		
PUNËT ADMINISTRATIVE – TEKNIKE	1		1			

PUNËT FINANCIARE - TË KONTABILITETIT	1					
PUNËT JURIDIKE	1					
VEPRIMTARIA THEMELORE	7	3	2	1		
MIRËMBAJTJA	4	1	1	1	1	
PUNËT LOGJISTIKE	7	1			1	
GJITHSEJIT - 38	23	6	4	3	2	0

- Numri total i të punësuarve tregon faktin se në këtë Shoqëri përqindja e pjesëmarrjes së pjesës administrative të punonjësve është nën 13.50% (5 punonjës në administratë prej 38 punonjësve), që është më pak se mesatarja në nivel shtetëror që është 25 %.

IX BORXHI

Me Programin e kryerjes së veprimtarië komunale për vitin 2026, Ushtruesi nuk planifikon borxh kreditor.

X PLANI I PROKURIMIT PUBLIK

Plani vjetor i Prokurimit Publik të Shoqërisë për vitin 2026 do të hartohet në përputhje me afatet e Ligjit mbi Prokurimin Publik ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 74/19, 03/23, 11/23, 84/24).

Në pjesën e akteve nënligjore veçojmë disa akte kryesore, në bazë të të cilave Shoqëria do të kryejë prokurimin publik në vitin 2026:

- Rregullorja për mënyrën e kryerjes së prokurimit të thjeshtë ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 16/23, 20/23, 36/23, 114/23, 49/24);
- Rregullorja për mënyrën e planifikimit dhe zbatimit të prokurimit publik të centralizuar ("Fleta zyrtare e MZ", nr. 69/20, 150/20, 139/22, 29/23).

NË TABELËN QË VIJON PARAQITET PLANI I PROKURIMIT PUBLIK PËR VITIN 2025

N.r.	Përshkrimi	Vlera e parashikuar duke përfshirë TVSH-në	Lloji i procedurës së prokurimit publik
I PLANI PËR MALLRA			
1.	Mjetet për mirëmbajtjen e higjienës	1.000,00	Prokurim i thjeshtë
2.	Materiali për zyrë dhe materialet tjera administrative	2.000,00	Prokurim i thjeshtë
3.	Shpenzimet e përfaqësimit, shpenzimet e bifes dhe kapsula kafeje	3.000,00	Prokurim i thjeshtë
4.	Shpenzimet e materialeve të tjerë	2.000,00	Prokurim i thjeshtë
5.	Shpenzimet për blerjen e pajisjeve dhe veshjeve për të punësuarit	500,00	Prokurim i thjeshtë
6.	Shpenzimet për blerjen e kompjuterëve dhe printerëve	2.000,00	Prokurim i thjeshtë
7.	Shpenzimet për blerjen e pajisjeve për zyra dhe objekte të tregut	2.500,00	Prokurim i thjeshtë
8.	Shpenzimet për blerjen e mobiljeve të zyrës	1.500,00	Prokurim i thjeshtë
I	VLERA TOTALE PËR MALLRA	14.500,00	
II PLANI PËR SHËRBIME			
9.	Shërbime të komunikimit	5.700,00	Prokurim i thjeshtë

10.	Organizimi i panairit	2.500,00	Prokurim i thjeshtë
11.	Shërbime të tjera	9.000,00	Prokurim i thjeshtë
12.	Zhvillimi dhe mirëmbajtja e softverit	3.000,00	Prokurim i thjeshtë
13.	Sigurimi i punonjësve	600,00	Prokurim i thjeshtë
14.	Shërbimet e dezinfektimit, dezinfektimit...	3.500,00	Prokurim i thjeshtë
15.	Përgatitja e planit të sigurisë në punë	2.000,00	Prokurim i thjeshtë
II	VLERA TOTALE PËR SHËRBIME	26.300,00	
	VLERA TOTALE (I+II)	40.800,00	

XI POLITIKA E ÇMIMEVE

Çmimorja aktuale e shërbimeve të Shoqërisë është përcaktuar dhe miratuar me Vendimin e Bordit të drejtorëve të Shoqërisë nr. 1102/23 prej më 18.12.2023, për të cilin Kuvendi i Komunës së Tuzit ka dhënë pëlqimin nr. 02-016/23-8550/1 prej më 28.12.2023 ("Fleta zyrtare e MZ - dispozitat komunale", nr. 03/24 prej më 11.01.2024).

Përveç çmimores në fuqi, është miratuar Vendimi i Bordit të Drejtorëve të Shoqërisë nr. 719/25 i datës 12.09.2025 për plotësimin e çmimores, për të cilin Kuvendi i Komunës së Tuzit ka dhënë pëlqimin me Vendimin nr. 02-016/25-7092/1 të datës 29.09.2025. Plotësimi i çmimores është bërë për shkak të nevojës për të përcaktuar më saktë çmimet e përdorimit të tezgave të pazarit për shitjen e djathit dhe vezëve, pasi këto kategori nuk ishin të përfshira veçmas në çmimoren aktuale.

Çmimorja në fjalë është përgatitur në përputhje me të gjitha rregulloret normative të vlefshme, të cilat dhe kjo përcakton në detaje arsyet e miratimit të çmimeve të reja dhe parametrat mbi bazën e të cilave janë përcaktuar çmimet për shërbimet e mirëmbajtjes së tregut.

XII VËREJTJET PËRFUNDIMTARE

Ky program ofron një pasqyrë të drejtimeve bazë strategjike dhe aktiviteteve të planifikuara me një vlerësim real të të ardhurave dhe shpenzimeve vjetore që mundësojnë realizimin e detyrave për të cilat është themeluar kjo Shoqëri. Zbatimi i aktiviteteve të përcaktuara nga ky Program kërkon përmirësimin e kushteve të punës në objektet e tregut që menaxhon Shoqëria - veçanërisht në tregun e mallrave të përziera, si dhe modernizimin e mëtejshëm të organizimit të punës.

Rrjedhimisht, Shoqëria do të vazhdojë me mirëmbajtjen cilësore dhe të vazhdueshme të objekteve të tregut dhe kryerjen e detyrave të tjera për të cilat është themeluar, duke u kujdesur që të sigurojë interesin publik dhe stabilitetin e veprimtarisë.

Në fund, duhet theksuar se si shërbim publik, ne llogarisim në bashkëpunim dhe ndihmën e Themeluesit, për të arritur qëllimet dhe aktivitetet programore, në mënyrë sa më efektive.

Numër: 889/25-1

Në Tuz, 15.12.2025

U.D. I DREJTORIT EKZEKUTIV

Ruzhdi Lluka



Të dorëzohet:

- Shërbimit të Kryetarit të Komunës
- Arkivit të Bordit të drejtorëve
- a/a